



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 2583 Prot.

Tiranë, më 13 . 03 .2017

UDHËZIM

Nr. 8 , Datë 13.03.2017

**PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË SHËRBIMEVE
ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, pika 4 dhe nenit 10 të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8 të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të nenit 9 dhe 10 të Ligjit nr.10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”,

UDHËZOJ:

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), është institucion publik i krijuar me ligj, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për mision ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e aksesit publik në fushën e arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar.
2. QSHA-ja ka për objekt veprimtarie ofrimin e shërbimeve për nxënësit, studentët, kandidatët për të marrë titullin e një profesioni të rregulluar, shkollat, IAL-të, Urdhrat profesionalë, institucionet dhe të tretët.
3. Shërbimet ndaj të tretëve ofrohen nga QSHA-ja pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin. QSHA-ja i ofron këto shërbime kundrejt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. QSHA-ja ka këto funksione:
 - a) Koordinon procesin e aplikimit në institucionet e arsimit të lartë, për ndjekjen e studimeve në programet e ciklit të parë, atyre të integruara dhe programet profesionale;

- b) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si Sekretariat Teknik i Komisionit për procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
 - c) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si Sekretariat Teknik i Komisionit për njohjen e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
 - d) Përcjell rezultatet e provimit të shtetit në ministritë e linjës, urdhrat profesionalë dhe njësitë arsimore vendore.
 - e) Krijon dhe administron regjistrin kombëtar të studentëve të të gjitha cikleve dhe një bazë të dhënash për institucionet e arsimit të lartë, lidhur me programet e studimit, diplomat apo certifikatat që ato lëshojnë.
 - f) Pajis çdo student, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë me një numër unik matrikullimi, për çdo cikël studimi. Ky numër e shoqëron studentin deri në marrjen e diplomës ose certifikatës për ciklin përkatës të studimit, sipas përcaktimeve të bëra me Udhëzim të Ministrit përgjegjës për arsimin.
 - g) Realizon studime që lidhen me provimet kombëtare dhe provimet e shtetit.
 - h) Merr masa për sigurinë e bazave të të dhënave që administron.
 - i) Ofron çdo shërbim tjetër, të lidhur me objektin e veprimtarisë së saj, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe shërbime të tjera të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin
5. Çdo institucion i arsimit të lartë raporton në QSHA, programet e studimit që ofrojnë dhe diplomat apo certifikatat që ata lëshojnë, sipas procedurës të përcaktuar me udhëzim të Ministrit përgjegjës për arsimin.
6. Çdo institucion i arsimit të lartë raporton në QSHA, të gjithë aplikantët e regjistruar në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve të larta, si dhe listën e të diplomuarve sipas cikleve, brenda afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
7. Çdo urdhër profesional dhe njësi arsimore vendore raporton në QSHA, listat e kandidatëve që do t'i nënshtrohen provimit të shtetit, për çdo profesion të rregulluar sipas afateve të përcaktuar me udhëzim të Ministrit përgjegjës për arsimin
8. QSHA-ja bën publike kuotat dhe kriteret e pranimit të përcjella nga IAL-të, për të gjitha ciklet e studimit.

9. QSHA-ja lëshon diplomën e maturës shtetërore, që është dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë është, dhe jepet pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të maturës shtetërore.
10. Struktura dhe organika e QSHA-së përcaktohen me urdhër nga Ministri përgjegjës për arsimin në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.
11. QSHA-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm.
12. Drejtori i përgjithshëm emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me Vendimin nr.173, datë 07.03.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”.
13. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të QSHA-së rregullohen në bazë të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, ”Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
14. QSHA-ja është institucion që financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e veta, si dhe ka të drejtën e administrimit të të ardhurave të krijuara, në masën 90 për qind të vitit buxhetor. Të ardhurat e papërdorura kalojnë në vitin pasardhës buxhetor.
15. Ministri përgjegjës për arsimin miraton Rregulloren e funksionimit të QSHA-së.
16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi, për vitin 2017, do të përballohen nga buxheti i këtij viti, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë arsimore vendore , Urdhrat Profesionalë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

